



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kačanik  
Municipal of Kačanik

01Nr. 60/01-27946/22  
Kaçanik, 26.10.2022

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **X (dhjetë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2022 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 26 tetor 2022. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përberja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 26. Mungoj me arsye, Agim Mani.

Nga Ekzekutivit i Komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës- Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Sali Malsiu-DSHMS, Ramadush Osmani-DSHPE, Suhad Dullovi- DBPZHR, Hafize Sallahu-DKRS, ndërkaq nga zyrtarët e komunës në kuadër të detyrave të punës ishin: Fatlume Guri-Selimi, Bejtulla Dalloshi, Hajrush Dullovi, Vedat Dema, Mavije Murseli, pati edhe zyrtarë tjerë që i përcjellën punimet e seancës (3).

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Gëzim Sahiti- zyrtar i lartë për monitorim të komunave në MAPL.

Mbledhjen e kryesoi, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit  
Procesmbajtës, Makfire Malsiu.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Kemal Murseli:** Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj pjesëmarrjen duke i thirrur emër për emër, prezentë në mbledhje janë 26 anëtarë, me arsye mungon Agim Mani, me ka njoftuar se është jashtë shtetit. Kushte pune për mbajtjen e mbledhjes kemi, e hapi mbledhjen e X (dhjetë) të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2022, data 26 tetor, me këtë:

## REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e kuvendit të komunës;
2. Raporti financiar për periudhën: Janar-Shtator 2022;
3. Propozim Vendimi caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023;
4. Plani i Veprimit për parandalimin e dhunës në familje, 2023-2025;
5. Informatë për fillimin e Vitit të Ri shkollor 2022/2023;
6. Informatë për përfundimin e Vitit shkollor 2021/2022;
7. Propozim Vendimi për realizimin e një vizite studimore e Kuvendit të Komunës Kaçanik në Republikën e Shqipërisë;
8. Propozim Vendimi për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2022; dhe
9. Propozim Vendimi për transferin dhe rialokimin e mjeteve buxhetore.

Lidhur me Rendin e propozuar të punës e hapi diskutim: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

## APROVON

### Rendin e punës në përbërje prej 9 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

#### 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës;

Vërejtje nuk pati në procesverbal, atëherë Kryesuesi i KK e shtroj në votim për aprovim Procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KK dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

## APROVON

**Procesverbalin e mbledhjes së IX (nëntë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 29.09.2022 / Lënda: 01Nr. 60/01-25557/22.**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Para se me kaluar në pyetje dhe kërkesa, iu njoftoj se asistentja e deritanishme, Arbnora Kuka është pranuar në DSHMS, ndërkaq tani asistente e Kryesuesit të Kuvendit është Mavije Murseli. Kalojmë në pozicionin e pyetjeve dhe kërkesave:

### Pyetje dhe Kërkesa

**znj. Ardita Rrahmai:** Çështja për te cilën do te flas, kalon animet politike e të gjithëve që jemi këtu, prandaj po ju drejtohem si një nënë, grua, familjare e edhe shoqe e dikujt që ka kaluar nëpër një fazë të errët të jetës, atë të ballafaqimit me sëmundje të kancerit të gjirit.

Duke pasur parasysh se jemi diku në fund të muajit tetor, në muajin e Fushatës së Sensibilizimit të Kancerit të Gjirit dhe nuk kemi as një aktivitet nga komuna. Nisur nga kjo, po vijë në përfundim se Ekzekutivi i Komunës nuk ka njohuri të mjaftueshme se çka është kjo sëmundje. Po detyrohem të tregoj se, Kanceri i Gjirit është një sëmundje globale, patologji malinje e cila fillon në indet e gjirit. Ky lloj i kancerit është i shfaqur kryesisht tek femrat mbi 50 vjeç, duke mos i kursyer edhe ato të moshës me të re. Në rast të identifikimit të hershëm, atëherë sëmundja edhe trajtohet. Në Kosovë si në mbarë globin rritja e numrit të grave me kancer të gjirit është shumë e madhe nga viti në vit. Edhe komuna jonë ka femra që ballafaqohen me këtë sëmundje edhe në këto momente që ne po flasim këtu. Pavarësisht sfidave, psikologjisë së dëmtuar të tyre, shpenzimeve enorme që ka trajtimi, shtu këtu që ka edhe raste që nuk mundën t'i mbulojnë shpenzimet për trajtim, institucioni i komunës këtë vit nuk e mori mundin me mbajturi se paku një ligjëratë apo një aktivitet sado simbolik për to. Përveç saj, një fushatë apo ligjëratë do t'i sillte edhe thirrjen për ndërgjegjësim dhe thirrjen për ekzaminim me të hershëm, qoftë edhe të dyshimit me të vogël tek gratë që mund të kanë këtë sëmundje. Në vitet paraprake është QKMF ajo që ka organizuar ligjëratë informuese, ende vazhdon të bëjë për stafin mjekësor. Përveç që e dhimbshme është e turpshme për ekzekutivin dhe neglizhencën ndaj kësaj kategorie.

**z. Adnan Reka:** Edhe njëherë dua ta përsëris pyetjen e mbledhjes së kaluar, meqë nuk mora përgjigje: A ka dikush nga ekzekutivi që i përgjigjet pyetjeve tona?

1. Çfarë doni të bëni me familjet që jetojnë pas xhamisë së dëshmorëve? Pas përfundimit të punëve të hekurudhës ato familje do të ngujohen plotësisht në shtëpi, sepse ata nuk do të kenë dalje tjetër përveç urës që e keni planifikuar mbi 'nerodime dhe hekurudhë' me një kod të ri prej 5,000€, e në fakt nuk e di a e keni në plan ta realizoni dhe kur, sepse kjo duhet të jetë urgjente?

2. Në mbledhjen e III (mars 2022) kam kërkuar një përgjigje me shkrim nga ju. Kryesues, lidhur me mungesën e arsyeshme (me pagesë, apo pa pagesë) të asamblistëve nga mbledhjet e rregullta të KK, dhe ende nuk e kam marrë përgjigjen.

3. Dhe, çfarë ndodhi me zërimin e ri, për Kuvend, për të cilin para disa muajsh ju thatë, së shpejti do ta kemi një zërim të ri si donacion nga një organizatë e huaj.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Muaji tetor është muaji i solidarizimit me kancer të gjirit. Unë nuk e kam të lehtë me folur për këtë çështje, sepse nga kjo sëmundje kam humbur edhe familjarë. Komuna nuk e ka treguar vetën në këtë drejtim, ashtu që me punësuar një femër në Zyrën për Barazi Gjinore, se po të ishte një femër në atë zyre, nuk do të ndodhnin do gjëra që kanë ndodhur me herët.

**z. Naim Beça:** Disa qytetarë janë ankuar shumë lidhur me deklaratë që e ka dhënë drejtori i DSHPE, Ramadush Osmani në RTK, çështja se njerëzit e zonave urbane janë me pak aktiv në punë vullnetare në krahasim me ata të zonave rurale. Unë nuk e kuptoj këtë çështje, drejtori duhet sqarohet para qytetarëve të Kaçanikut se çka dashur me thënë, se janë mbi 20 qytetarë të komunës që me kanë shkruar për këtë çështje. Drejtori duhet ose të kërkoj falje ose të del me një sqarim se çka ka dashur me thënë. Mua jeta me ka shkruar duke kryer punë vullnetare nëpër organizata të ndryshme, ndërkaq me dalë në TV drejtori me një deklaratë të tillë, kujtoj se nuk ka logjikë.

**znj. Fitore Vishi:** Jam e obliguar që para jush t'iu njoftoj nga largimi i pozitës time të Shefes së Grupit Parlamentar të PDK, për shkak të angazhimeve dhe obligimeve të punës. Me largimin tim konfirmoj se PDK e propozon për Shef të Grupit Parlamentar të PDK, z. Rustem Zenuni.

**z. Agim Çaka:** Pyetjet të cilat i kemi ngritur në seancat e kaluara, po na duhet me i përsëritur për shkak se nuk po marrim përgjigje. Në mbledhjen e kaluar unë e bëra një pyetje dhe e ngrita si shqetësim, çështjen e mbeturinave në rrugën "Idriz Seferi". U bënë 1 muaj ditë dhe mbeturinat janë ende aty, ato janë mbeturina inerte që shihet se dikush i ka hedhur aty se nuk janë të lagjes. A është caktuar ndokush me u marrë me këtë çështje, a është shkruar dikush me monitoruar atë vend? Ne kemi bërë kërkesë me pasur në KK një monitor që me i pa këto çështje përmes monitorit, se kjo është një pasqyrë e keqe për komunën tonë. Për pyetjen e ngritur për çështjen e hekurudhës, nuk kemi marrë përgjigje. A ka bërë ndokush tendencë me bërë ndonjë zgjidhje, se në komunën e Ferizajt veç po intervenohet. Çdo kërkesë që ngritet në KK, me vendosur një rend, me ditur se cilat nga kërkesat kanë marrë përgjigje e cilat jo.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Lidhur me përgjigjet në pyetje dhe kërkesa, ekzekutivi i komunës është i obliguar me i kthyer përgjigje. Nëse jeni të pajtimit, përgjigjet të cilat i bënë ekzekutivi mundemi me ua dërguar të gjithëve. Unë kam një kërkesë që anëtarët e KK- femrat, pas mbledhjes të ndalen të formojnë Grupin Joformal të Grave. Kalojmë në pikën vijuese:

## 2. Raporti financiar për periudhën: Janar-Shtator 2022;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**z. Adnan Reka:** Duke u bazuar në raportin financiar janar – shtator 2022, i cili pasqyron të hyrat dhe shpenzimet e komunës tonë për këtë periudhë, ne konsiderojmë se komuna jonë ka pasur një shkallë me të ulët të inkasimit të të hyrave vetanake për 131.292€, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, tek të hyrat direkte. Është interesant të vërejmë se shumica e programeve buxhetore kishin bilanc negativ, përveç inspektoratit nga shqiptimi i gjobave dhe një shume të vogël në programin, buxhet dhe financa. Kur jemi te shpenzimet e buxhetit komunal, mund të vërejmë një performacë më të dobët për 6,21 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Nëse e marrim kategorinë ekonomike investime kapitale, mund vërejmë se janë realizuar 24.66 % nga buxheti total, vetëm nuk duhet të anashkalojmë as faktin se kemi 19.48 % me pak investime kapitale të realizuara, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në anën tjetër, kemi realizimin e shpenzimeve të planifikuara sipas kategorive ekonomike për 9 muaj, ku janë shpenzuar vetëm 15.26 % për Investime Kapitale, 10.33% për Mallra dhe Shërbime, 3.40% Subvencione dhe Transfere , dhe vetëm 1.35% Shpenzime Komunale, të cilat konsiderojmë se janë tepër pak për një periudhë 9 mujore. Kur jemi te përmbledhja e shpenzimeve në mallra dhe shpenzime, kemi: Udhëtime zyrtare jashtë vendit, 568€. A mund t'na tregoni edhe neve, ku, kur dhe pse ka pas udhëtime jashtë vendit?

Shpenzimet e telefonisë mobile, 3,835€, edhe pse janë më të vogla se vitin e kaluar, prapëseprapë konsiderojmë se janë shumë shpenzime për 9 muaj, kur e dimë faktin se, vetëm 5 euro kushton një pako interneti me të gjitha shërbimet e nevojshme për 1 muaj. Shpenzime të përfaqësimit dhe avokaturës, 2,296€, për cilat raste komuna duhet të paguaj avokat? Komuna ka përfaqësuesit e saj ligjor. Shpenzime për shërbime kontraktuese - gati 58.000€, çfarë shërbime kontaktuese keni paguar? Shpenzime për anëtarësim -5.011€, për çfarë anëtarësime bëhet fjalë? Mobilje (më pak se 1000€) - zyra e kryetarit, 5.050 €, nuk kemi pa asnjë ndryshim të mobileve në zyrën e kryetarit. Furnizim me ushqim dhe pije, 10,779€, ndonëse janë më pak se vitin e kaluar prapëseprapë janë shumë, po ta shihni vitin e kaluar do të vëreni një paradoks, kishim 20,363€, për ushqim dhe pije, ndërsa vetëm 9,562€ për furnizime mjekësore. Shpenzime për vendime të gjykatave, 8.862€, do të thotë se qytetarët paguajnë gjoba edhe për shkak të keq-menaxhimit. Raportet financiare janë dokumente që pasqyrojnë gjendjen e saktë në komunë, këtë gjë edhe më qartë e kishte thënë, edhe auditori i shtetit për vitin e kaluar.

**z. Betim Shala:** Ne si LDK i kemi vërejtjet tona në raportin financiar të HVK, raporti në mes planifikimi dhe realizimit, 76.85% apo 577.278.5€, të planifikuara 751205.6 €. Në mbledhjen e dytë të rregullt drejtori i financave në raportin nëntëmujor 2021 thotë: “Para se me dhënë përgjigje, nëse e keni shikuar raportin e të HVK, është realizuar në performancë të lartë, e kemi tejkaluar planin qysh në shtator të hyrat direkte”. Çdo euro e inkasuar, pas muajit shtator paraqet tejkalim të HVK. Në raportin e tanishëm janë të paraqitura vetëm të hyrat direkte. Përveç inspektorati që ka shënuar ngritje të HVK, të gjitha drejtoritë tjera kanë shënuar rënie, ka drejtori që ka pësuar rënie dyfish të HVK, dhe nëpër sektorë të caktuar që ka inkasuar 13 herë me pak të hyra. Nisur nga kjo rënie, ne kemi bërë një krahasim edhe me vitin 2020 në kohë pandemie, me këtë vit në sektor të caktuar.

E gjithë kjo, jo vetëm se ka ulur të HVK, por ka ndikuar në ekonominë familjare. Shpenzimet kapitale 24.66%, krahasuar me vitin e kaluar ka rënie të rendimentit. Në vitin e kaluar komuna në këtë periudhë kishte shpenzuar 35.88%, që i bie 11.32% me tepër se në këtë vit. Në vitin 2020 shpenzimet kapitale ishin 23.68%, pra ekuivalente me këtë vit. Bazuar në këtë ecuri të shpenzimeve, kam frikë se shumica e mjeteve nga Granti qeveritar do të shkojnë në suficit buxhetor, gjë që do të ishte e dhimbshme për një komunë të varfër siç është Kaçaniku.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Pyetje për drejtorin: Të inkasimi i të HVK, taksat sipas drejtorive, të drejtorisë e Administratës, taksat tjera administrative, janë planifikuar 100€ për periudhën janar-dhjetor 2022, ndërkaq të hyrat janë 2871.03€. Cilat kategori të taksave hynë këtu dhe pse nuk janë specifikuar me emër llojet e taksave në tabelë të cilat i janë ngarkuar qytetarët?

**z. Rrustem Zenuni:** Po ndërlidhem me diskutimin e Admanit dhe Kadrijës. Të shpenzimet kapitale, nuk është se komuna nuk ka dashur me realizuar me tepër mjete, por duhet pasur parasysh se në tre mujorin e parë janë shpenzimet me të ulëta për shkak të faktorit kohë. Në tremujorin e dytë ka pasur një ngërç për shkak se nuk ka funksionuar OSHP. Inflacioni i lartë ka ndikuar në ngritjen e çmimeve edhe të ne. Të pyetja e Betimit, është e njëjta përgjigje duke pasur parasysh se inflacioni ka ndikuar shumë, pastaj të HVK në muajin shtator ka pasur grevë dhe kjo ka ndikuar në inkasim të ulët, sepse shumë qytetarë kanë dashur me kryer obligimet e tatimit në pronë, por nuk kanë mundur me i kryer për shkak të grevës.

**znj. Ardita Rrahmani:** Nuk e pata ndërmend me marrë fjalën, me nxiti parafolësi. Pyetjet të cilat u bënë nga opozita, nuk ishin për juve z. Zenuni, pyetjet ishin për drejtorin e financave, ekzekutivin e komunës, por nganjëherë mundoheni të bëheni avokat i dikujt. Kjo praktikë nuk është e mirë që pyetjeve të ekzekutivit me iu përgjigjur anëtar i KK, se kjo veç po nxitë debat pa nevojë.

**z. Rrustem Zenuni:** Jo që dua me u bërë avokat i drejtorit, por me pengon situata e viktimës, që nuk i sheh punët e mira që janë bërë. Unë nga ju nuk e pres këtë vlerësim se keni punuar në ministri dhe e dini si funksionon shteti.

**z. Betim Shala:** Duke marrë për bazë faktin se kriza e ka kapluar gjithë botën, unë i bëra disa krahasime të çështjeve buxhetore me vitin 2020, kur ka pasur pandemi e që komuna ka punuar me staf të reduktuar, ndërkaq realizimi i buxhetit ka qenë me i mirë se në këtë periudhë buxhetore.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Çështja e inflacionit dhe ngritjes së çmimeve ka ndikuar tek të gjithë, këto probleme janë duke i pasur edhe në nivelin qendror përderisa qeveria ta gjënë një zgjidhje.

**z. Adnan Reka:** Ne z. Rrustem po e paraqesim gjendjen reale si është e pasqyruar në buxhet, pse janë inkasuar e realizuar me pak mjete buxhetore në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

**z. Bahri Selimi:** Kritikat e juaja janë me tepër të te HVK dhe të shkalla e investimeve kapitale. Si ekzekutiv, ne mendojmë se shkalla e ekzekutimit të buxhetit është e kënaqshme, marrë parasysh efektet që po i shkakton lufta në Ukrainë dhe rritja e inflacionit. Të HVK, 74.75% është realizimi të ato direkte, nuk mendojmë se është i ulët ky inkasim se kemi arritur shkallën e kënaqshme për 9 muaj pjesëtuar me 25%, me çka mund të barazohemi në tremujorin e fundit apo edhe të tejkalojmë planifikimin. Të HVK janë realizuar për projekte kapitale, ekziston mundësia me u bartë në vitin vijues ato mjete që mbesin, ku 706.000€ i kemi bartur nga viti i kaluar e që është rritur buxheti. Të HVK 95% janë të orientuara në Investimet Kapitale, nëse nuk shpenzohet, lejohet bartja e tyre. Pjesë e raportit është edhe muaji shtator, i cili muaj ka qenë në grevë, e që komuna ka punuar vetëm pjesërisht për raste emergjente, ndërkaq ka pasur interesim për pagesën e Tatimit në pronë, dhe kjo ka ndikuar në uljen e të HVK edhe në drejtorinë që e udhëheqë unë për 18.000 €. E dyta, taksat komunale për leje ndërtimi, 8726€, ku jemi minus për 105.000€. Vazhdojnë të jenë të liruar ende shfrytëzimi i pronave komunale, participimet në shëndetësi si rezultat i pandemisë dhe nuk ka të dhëna zyrtare se pandemia ka përfunduar. Të IK efekte negative ka shkaktoar lufta në Ukrainë, inflacioni lidhur me kontratat që i kemi pasur me operatorët ekonomik. Ngeje në realizim është vërejtur edhe të ministritë, ku në masë monetare ne kemi shpenzuar për 200.000€ me pak. Në konsultimet e brendshme me drejtorët, janë duke vazhduar realizimi i projekteve, koha po mban mirë, pagesat bëhen në muajin dhjetor dhe rritet shkalla e shpenzimeve. Operatorët ekonomik po hezitojnë të kryejnë punë sipas kontratave të lidhura me herët, se nga niveli qendror është duke u pritur një ndryshim që ua mundëson atyre harmonizimin e çmimeve karshi inflacionit. Si rezultat i politikave qeveritare ka ngelë puna edhe në komuna. Të kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve jemi munduar me qenë sa me transparentë se ku janë shpenzuar mjetet. Të pyetjet që u ngritën, do mundohem me iu përgjigjur: Çështja e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit, nuk shquhem shumë për vizita, 568 € janë të vitit të kaluar nëse nuk gaboj, të drekat zyrtare drejtori i potencoj shumat e shpenzuara. Të avokatura, është një vendim i qeverisë për ata që kanë borgje mbi 300€, nga MEF është marrë vendimi që lëndët me u dërguar në përmbarues. Ne e kemi bërë një listë për borgjëlinjtë e mëdhenj, sidomos për bizneset në përmbarues. Ne e paguajmë përmbaruesin, ndërkaq të hyrat kur realizohen shndërrohen në të HVK. Kjo nuk ka të bëjë me avokat, por kodi ekonomik në planin kontabël shënohet kështu, shpenzimet e përfaqësimit dhe avokaturës. Të shpenzimet kontraktuese tjera, këtu hynë sigurimi fizik i objekteve, me çka shkaku i inflacionit kanë ndryshuar kontratat. Gjithashtu janë ngritur shpenzimet për lëndë djegëse për nxehje. Të mablet dhe pajimet, janë bërë disa renovime të vogla të Zyra e Nënkrëtarit. Ushqim dhe pije, u përmend se janë shpenzuar me pak mjete.

**z. Naim Beça:** Kërkoj sqarim të pozicionit, shpenzimet e ndryshme shëndetësore ?

**z. Bahri Selimi:** Të shuma 1730€ të shpenzimet e ndryshme shëndetësore, është fjala për furnizimet të cilat bëhen në QKMF. E përmenda edhe me herët që janë rritur të gjitha çmimet, kategoria me e afektuar janë, mallrat dhe shërbimet dhe investimet kapitale. Të QKMF e kemi pasur problem me i realizuar të gjitha kërkesat, se kemi ende kërkesa të cilat nuk kemi mundur me i proceduar në mungesë të mjeteve. Të shpenzimet ushqim dhe pije, janë për pako ushqimore për qytetarë, këtu hynë edhe bufeja e komunës që nuk e kalon shumë 6,000€ në vit. Në përgjithësi janë shpenzuar me tepër mjete për pako ushqimore. Të taksat tjera që e potencoj znj. Kadrije, janë planifikuar 100€, të hyrat janë të përgjithësuara, se duhet me u koduar vit pas viti në formë me specifike.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Cilat taksa kanë hyrë të pozicioni, taksat administrative tjera? Qytetari duhet me ditur se në cilën kategori hyjnë këto taksa, se ato taksa shkojnë direkt në uniref në bankë në atë kategori.

**z. Bahri Selimi:** Ka mundësi janë paguar certifikata të lindjes, kurorëzimit apo ndonjë certifikatë tjetër, e nuk kanë hyrë të kodi përkatës. Këto të hyra janë brenda DAP, unirefi është dhënë joadekuat, qytetari nuk është ngarkuar me pagesa shtesë. Kjo është edhe shqetësim i yni dhe po ia lëmë administratës së përgjithshme me u marrë me këtë çështje dhe me dalë me një informatë për këto pagesa.

**z. Naim Beça:** Ne nuk jemi shumë profesionistë të kësaj fushe, unë nuk i kuptoj sa duhet pozicionet: shpenzimet e furnizimeve mjekësore dhe shpenzimet e ndryshme shëndetësore, kodi 13230 dhe 13430, se po me duket një shumë e vogël e shpenzimeve për furnizime mjekësore, marrë parasysh inflacionin, se edhe të këto shpenzime duhet të përmendim inflacionin.

**z. Bahri Selimi:** Shpenzimet e furnizimeve mjekësore është edhe drejtori këtu se unë nuk i kuptoj shumë, 15128 € janë sivjet, vjet kanë qenë 9.562 €, është një diferencë e shpenzimeve se janë rritur çmimet. Për mos me iu marrë shumë kohë, ua dërgoj të dhënat me email, bëhet fjalë për një shumë 1700 €.

**z. Adnan Reka:** Faleminderit drejtor për sqarimet. Ne nuk përmendem dreka zyrtare, ne kërkuam sqarime për udhëtimet zyrtare, pavarësisht shumës. Të shërbimet e ndryshme intelektuale këshillëdhënëse 250€ për secilin program buxhetor, 250 € administrata, urbanizmi, bujqësia, financa, të gjitha nga 250 €. Nuk e di a është reale kjo, a nënkupton kjo që një këshillë intelektuale kushton 250 € ? E dyta, ushqim dhe pije dhe furnizimet mjekësore, është paradoks me shpenzuar me tepër mjete në ushqim dhe pije, sesa për furnizime mjekësore, se janë shpenzuar dyfish me tepër mjete.

**z. Bahri Selimi:** Që të jemi më konkret, furnizimet mjekësore është obligim i ministrisë së Shëndetësisë. Komuna i furnizon disa artikuj me të veçantë, se furnizimet i bënë ministria se janë në përgjegjësi të saj me e furnizuar QKMF me barna dhe medikamente tjera.

**z. Adnan Reka:** Komuna iu jep prioritet se cilat janë shpenzime me prioritet. E dyta, shpenzimet kontingjente të shpenzimet e vendimeve të gjykatave 8862 €, duhet paguar edhe keq menaxhimin e komunës kur gjobiten. Sidoqoftë, konstatoam se keni bilanc negativ edhe të te HVK dhe të shpenzimet, ndërkaq arsyet mund të jenë të ndryshme.

**z. Bahri Selimi:** Të shpenzimet e buxhetit, është e vërtetë, 6.21% janë shpenzuar me pak, apo në masë monetare 336228€. Për neve nuk është shumë alarmante bazuar në punët që i kemi në terren dhe punët tjera në komunë, besoj se ka me u përmirësuar gjendja e mjeteve të shpenzuara.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatohet se Kuvendi i Komunës,  
u

## NJOFTUA

**Me Raportin Financiar për periudhën: Janar-Shtator 2022/ Lënda: 01Nr. 104/02-28046/22.**

**3. Propozim Vendimi caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023;**

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**z.Adnan Reka:** Çka nënkupton pasuesi, me përjashtim të pronës publike ?

**z. Bahri Selimi:** Të pronat publike, ju e dini se vitet e fundit tatonen edhe pyjet, tokë bujqësore, Parcelat që janë pronë komunale, nuk tatonen. Nuk tatonen edhe objektet komunale, objekt të AKP etj.

**z. Adnan Reka:** Në vend se t'i ulni normat tatimore për qytetarët në këtë kohë të inflacionit global, ju doni t'i rëndoni edhe më tepër qytetarët, duke ua ngritur normat tatimore për toka, shtëpi e banesa. Ne jemi kundër kësaj mendësie të qeverisjes.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Normat tatimore nuk i cakton komuna, i cakton niveli qendror. Tavani me i ulët është 0.15% për ekonomi familjare dhe 0.18 % është tavani me i lartë për pronat që tatonen në komunë, ndërsa komuna nuk mundet me lëvizur me poshtë se 0.15% as me lartë se 0.18%, Komuna e Kaçanikut ka shkuar me normat minimale. Është mirë që nuk kanë lëvizur këto norma për shkak të gjendjes së komunës tonë, kështu kanë qenë edhe vitin e kaluar, nëse ka ndryshuar diçka në ligjin e ri, unë nuk e di.

**z. Bahri Selimi:** Me ligjin e ri, janë ngritur kufijtë, neni 9 i Ligjit të Tatimit në Pronë, thotë se: KK i çdo komune i cakton normat tatimore për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike. Ne i kemi caktuar normat tatimore për ekonomi familjare 0.15%, njëjtë me vitin e kaluar. Të 1.2 të objektet bujqësore, norma tatimore është caktuar 0.15 %. Për njësitë rezidenciale, normat tatimore i kemi caktuar 0.15%. Në vazhdim drejtori e citoj ligjin sesa munden me qenë normat tatimore dhe sa i kemi përcaktuar duke shkuar në shkallë minimale, të caktuara në nenin 9 të ligjit të tatimit në pronë.

**z. Adnan Reka:** Ne po i referohemi këtij dokumenti të cilin na e keni ofruar, ku thuhet: Kuvendi i Komunës Kaçanik cakton normat tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike. Ju po e përjashtoni kategorinë e pronës publike, ndërsa ua ngritni normën tatimore qytetarëve. Në rregull, ju jeni shumicë dhe mund të merrni vendime.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 18 votë Për (12 PDK, 2 AAK, 4 LDK). Kundër 5 LVV, Abstenuan 2 nga LVV, Naim Beça dhe Raif Kasa. Pjesëmarrës në votim, 25 anëtarë. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

### VENDIM

**Për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023 / Lënda: 01Nr. 430/03-27545/22.**

**4. Plani i Veprimit për parandalimin e dhunës në familje, 2023-2025;**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Koordinatorin që e ka hartuar këtë plan është këtu, është diskutuar edhe në KPF, ka pasur një diskutim të mirë, e hapi diskutimin:

**znj. Fitore Vishi:** Materiali i përgatitur është mjaft voluminoz, është përmbajtjesor, i pagatitur meritueshëm dhe me përgjegjësi profesionale nga hartuesit kompetent të dikastereve përkatëse. Ky plan i veprimit është gjithëpërfshirës, bazuar në kërkesat dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje -Konventa e Stambollit. Rreth këtij dokumenti mund të ketë debate të mira dhe konstruktive, por gjenerali-teti i tij është i lidhur domosdo me këshillat tjera të shoqërisë tonë dhe Kaçaniku nuk bënë ndonjë përjashtim nga komunat tjera të Kosovës. Sensibilizimi i shoqërisë tonë mbi problematikën e dhunës në familje dhe dhunën ndaj grave mund të bëhet edhe përmes udhëzimeve me shkrim në formë fletushkave, duke i shpërndarë ato në lagje e fshatra, duke organizuar takime me grupe të grave e vajzave, burrave e të rinjve si formë preventive për vetëdijësimin e komunitetit dhe parandalimin e fenomeneve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Ky dokument është solid për të vepruar në bazë të tij.

**znj. Ardita Rrahmani:** Ne kemi zhvilluar një debat për këtë çështje edhe në KPF. Në buxhetin e miratuar janë paraparë vetëm 1000€ për 1 vit të cilat mjete do t'i jepen qendrës rehabilituese "MY HOME" në Ferizaj, e cila shumë nuk është e mjaftueshme. Në tabelë të materialit janë të paraqitura vetëm 9 raste të identifikuara, që mendoj se janë pak se ka raste me tepër të dhunës në familje, e kuptoj se kjo është në kompetencë të policisë së Kosovës. Po ashtu në tabelën 9.4 paraqitet fuqizimi i rolit të gruas në shoqëri, përmes punësimit të femrave në pozita vendimmarrëse, ku aktivitetet të cilat mundohet me i realizuar i ka paraparë përmes komunës, OJQ -ve lokale dhe Grupit të Grave Asambleiste. Grupi i grave nuk është funksional, e kuptuam që do të formohet sot, ka muaj që e kam kërkuar formimin e këtij grupi. Kur është hartuar ky plan, a e keni ditur që nuk ka qenë i formuar Grupi i grave. Ne po i bëjmë gati një vit që jemi pjesë e kësaj legjislature dhe nuk e kemi formuar këtë grup.

**z. Vedat Dema- KDNJ dhe ZBGJ:** Ky Plan i veprimit është i bazuar në infrastrukturën ligjore të Kosovës, Ligjet, Strategjinë kombëtare. Kur është hartuar Plani i veprimit për vitin 2023-2025, ne kemi qenë rregullisht në kontakt me OSBE-në për formimin e Grupit të grave, por unë nuk jam ai që marrë iniciativë për formimin e këtij grupi. Unë jam ai që i mbështeti Grupin e grave, iu ofroj plane, raporte, pasi iniciativat e tilla i merr OSBE-a. Me Grupin e grave të legjislaturës së kaluar kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë për aktivitete të ndryshme. Për atë e kam paraparë formimin e këtij grupi në bashkëpunim me OSBE-në dhe ky grup me qenë prezentë në aktivitetet të tilla. Unë fushata vetëdijësuese mbajë edhe për mekanizmin e dhunës në familje, e kam planin dhe raportin të cilin e paraqes para jush, mbajë aktivitete të ndryshme qoftë për fuqizimin e grave, trashëgimi, është fushata 10 ditore kundër dhunës në familje. Përveç këtij mekanizmi i përfshijë të gjitha institucionet, në komunën tonë, kemi paraparë dhunën në familje, ku përfshihen aktivitete të ndryshme që kanë të bëjnë me integrimin, parandalimin dhe mbrojtjen e rasteve të dhunës në familje. Raste të dhunës në familje ka me tepër, unë edhe në KPF i kam dhënë shifrat. Në vitin 2019 kanë qenë 19 raste, por nuk do të thotë që të gjitha rastet shkojnë në strehimore. Të dhënat dhe statistikat janë prej akterëve të cilat janë marrë nga: Strehimorja, Policia dhe QPS. Në bashkëpunim me këta akterë e kemi bërë në Planin e veprimit dhe unë jam zgjedhë koordinator. Mekanizmi kundër dhunës në familje është krijuar në vitin 2021, në vitin 2022 kemi startuar, ku kemi mbajtur takime të ndryshme me akterë dhe e kemi hartuar këtë plan.

**z. Adnan Reka:** Çfarë vërejtja unë në këtë plan, ishte numri i madh i rasteve sociale, që në vazhdimësi sillen rreth 800. Këtë vit kemi 816 raste sociale, do të thotë më shumë se secila Komunë e Kosovës, marrë parasysh numrin e popullsisë. Ne e përkrahim këtë plan të veprimit, por urojmë që të zbatohet e të mos mbetet vetëm në letër si shumë plane tjera.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Grupi i grave do të formohet pas mbledhjes së KK. Grupi i grave asambleiste është jo formal, është një grup që me tepër bazohet në vullnetin e juaj, sesa obligim

ligjor i imi të formoj këtë grup. Është mirë dhe duhet të funksionoj ky grup, sepse përfaqëson një gjysmë të popullsisë në aspektin e gjinisë dhe ngrijës se shqetësimeve të rasteve të dhunës në familje. Nuk ka qenë neglizhencë e imja formimi i këtij grupi, më tepër mos angazhim dhe mos vullnet se unë kam thënë para disa muajve, ndaluni të formojmë këtë grup, dhe nuk kanë qëndruar të gjitha femrat me formuar këtë grup. Sot e kam marrë këtë iniciativë, e lëmë edhe për shkak të presionit të Arditës, edhe pse nuk është ashtu, pas mbledhjes do të formojmë Grupin e grave asambleiste.

**z. Vedat Dema:** Sa i përket Grupit të grave, unë e kam edhe rregulloren sesi formohet ky grup, mundem me u ofruar edhe një plan të veprimit të grupit të grave të mëhershme, por duhet pasur parasysh se plani ka kosto buxhetore.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Pjesëmarrës në votim, 25 anëtarë. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### **VENDIM**

**Për miratimin e Planit të Veprimit për parandalimin e dhunës në familje, 2023-2025 / Lënda: 01Nr. 104/02-26050/22.**

5. Informatë për fillimin e Vitit të Ri shkollor 2022/2023;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Drejtori nuk është këtu për shkak të një angazhimi që kishte, mirëpo është zyrtari nga drejtoria e arsimit, e hapi diskutimin. Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë konstatoj se KK u,

#### **NJOFTUA**

**Me Informatën për fillimin e Vitit të Ri shkollor 2022/2023. / Lënda: 01Nr. 04-60/01-27763/22**

6. Informatë për përfundimin e Vitit shkollor 2021/2022;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**z. Adnan Reka:** Sa i përket Informatave të DKA-së, konsideroj se janë dokumentet më serioze të ekzekutivit të komunës në aspektin e përpilimit dhe informacionit, përkundër vërejtjeve që kam për vonesën e Informatës për përfundimin e Vitit shkollor 2021/2022 që është dashur të vijë me të përfunduar viti shkollor në fund të gushtit apo më së largu në fund të shtatorit, sepse informatat në kohë të ndryshme edhe efektet i kanë të ndryshme. Megjithatë, unë dua të ndalem vetëm te tabela faqe 18, që më së miri pasqyron gjendjen e cilësisë në edukim fillor dhe të mesëm të ulët në Komunën tonë, nga viti 2016 deri në vitin 2022, kemi një rënie të theksuar të cilësisë në arsim; pra, këto të dhëna tregojnë qartë për rënien e vazhdueshme të cilësisë së edukimit në shkolla tona.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Arsyeja pse ka ardhur në këtë kohë, edhe me plan të punës është e paraparë me u shqyrtuar në këtë muaj. Viti shkollor përfundon me 31 gusht, me çka drejtoria është e fokusuar me tepër në fillimin e vitit shkollor, sesa me raportet e përfundimit të vitit shkollor. Kur është përpiluar plani i punës së KK është diskutuar kjo çështje. Informata e fillimit të vitit shkollor duhet me të procedohet me herët, në mbledhjen e shtatorit, ndërkaq kjo është me plan në muajin tetor. Nëse është e nevojshme me plan të punës së KK e ndryshojmë.

**z. Rrustem Zenuni:** E përgëzoj vendimin e organeve komunale për mbulimin e shpenzimeve të nxënësve që udhëtojnë të SHMP, është vendim i qëlluar, sepse të gjithë ata nxënës që janë në SHMP po aftësohen për treg të punës.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Sa përket mjeteve të ndara për bursa për nxënës të SHMP, unë e kam ngritur si shqetësim edhe në KPF, se kemi pasur ankesa nga prindërit e SHM "Skënderbeu" se është bërë një diskriminim në mes të nxënësve, kur e dimë se nxënësit shkojnë në shkollë për të njëjtin qëllim për me nxënë dije dhe i përkasin të njëjtës komunë dhe janë nga të njëjtat zona rurale. Për mua dhe për prindërit kjo është një shqetësim shumë i madh, se është bërë diskriminim në mes të nxënësve me ndarjen e bursave nxënësve të SHMP.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Jemi duke folur për informatën e përfundimit të vitit shkollor, kompensimet e shpenzimeve të udhëtimit janë ndarë sivjet.

**znj. Ardita Rrahmani:** Ne LDK e kemi pasur në programin tonë të punës, ndarjen e bursave për nxënës të dy shkollave. Kur kemi premtuar, keni thënë se nuk realizohet, tani po shihet se paska mundësi me u realizuar. Njëherë është filluar në njërin shkollë, më vonë ndoshta realizohet edhe shkollës tjetër.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Brenda mundësive buxhetore që ka pasur komuna është vendosur ndarja e bursave vetëm për nxënës të SHMP.

**z. Selajdin Troni:** Unë kërkoj që të shqyrtohen mundësitë buxhetore me ua kompensuar shpenzimet e udhëtimit edhe nxënësve të SHM "Skënderbeu". Nëse nuk ka mundësi për të gjithë, me ua kompensuar se paku atyre nxënësve që nuk kanë mundësi buxhetore.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Esenca e këtij vendimi ka qenë, stimulimi i nxënësve me iu qasur SHMP. Nuk besoj se ka pasur qëllim parësor me trajtuar aspektin ekonomik e social, padyshim se përfshihet edhe ky aspekt. Qëllimi ka qenë që nxënësit të orientohen me tepër në aftësimin profesional, duke ditur sesi kanë qenë orientimet e nxënësve në atë shkollë me herët, ku në SHMP kanë shkuar nxënës me sukses me të dobët.

**Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi:** Meqenëse vijë fusha e arsimit dhe kam punuar në arsim në SHMP, po mundohem me kontribuar në këtë drejtim. Vendimi që është marrë për kompensimin e shpenzimit të udhëtimit të nxënësve të SHMP është i qëlluar. Mendoj se jo vetëm ne, por edhe ju anëtarët e KK duhet me kontribuar që t'ia ndryshojmë qasjen SHMP, marrë parasysh se jemi në sistemin e ekonomisë së tregut, ku duhet me i përgatitur nxënësit për tregun e punës. Është rritur kërkesa e nxënësve, por edhe e atyre që jetojnë në diasporë, me marrë diplomë profesionale që iu përgjigjet tregut të tyre të punës në vendin ku jetojnë, sepse me tepër po e gjejnë vetën në treg ata të cilët po e kryejnë një profesion si nxehje, ujësjellës, elektrikë, e që bëhet një punë shumë e mirë nga kolegët e asaj shkolle. Vetëm në vitin 2021 janë punësuar nxënës në KEDS dhe qendër të karrierës profesionale, diku 51 nxënës të dalë nga kjo shkollë. Të dhënat mund t'i merrni nga shkolla dhe KEDS. Nuk ka vit që nuk pranohen në shkollën e KEDS akademi 5,7,9 nxënës, që është një prej shkollave me të çmuara në Kosovë. Vendimin që e ka marrë kryetari është shumë i qëlluar si motivim që nxënësit me shkuar sa me tepër në SHMP, në të njëjtën kohë duke menduar me iu dhënë qasje edhe gjimnazit. Ju e keni parë edhe kalueshmërinë që ka qenë sivjet në SHMP që ka qenë pak me e lartë. Në të njëjtën kohë është mbajtur edhe një garë me grupe prej shkollave, edhe kjo ka qenë motiv për ata nxënës që i kanë nxënë vendet e para për një ekskursion me i shpërblyer për punën që e kanë bërë dhe me i motivuar edhe nxënësit tjerë me punuar me tepër. Sa i përket cilësisë në arsim, statistikat janë këto që janë. Në SHMP mesatarja ka qenë me e ulët, se nxënësit vijnë në atë shkollë me nota me të dobëta, janë ata nxënës që i ka pasur Adnani dhe arsimtarët tjerë, rezultatet kanë qenë pak me të dobëta, kështu që jemi duke u munduar këta nxënës me i përgatitur për tregun e punës, kjo është arsyeja.

**z. Adnan Reka:** Është e vërtetë se vërtetë se Adnani dhe arsimtarët tjerë i kanë përgatitur ata nxënës, por mos harroni se edhe ata nxënës vijnë nga një nivel tjetër para se ma ardhur të Adnani e që fatkeqësisht kemi shumë mangësi të nxënësve që vijnë nga institucionet parashkollore dhe para fillore, e që janë si rezultat i qeverisjes 20 vjeçare të juaj, por nuk e di a mendoni ju, ju në fakt edhe thatë, për mua kjo është e papranueshme se kjo duhet të jetë qasja që t'i joshni fëmijët përmes parasë apo përmes transportit dhe të bëni një shkollë kinse me të mirë. Unë mendoj se qasja ose joshja e nxënësve duhet të jetë përmes cilësisë dhe rregullit në atë shkollë, që fatkeqësisht ka munguar për vite me radhë, prandaj kemi pasur rezultatin që as gjysma e nxënësve nuk e ka kaluar testin e maturës. Për këtë unë nuk e di kush është me tepër apo me pak fajtor.

**z. Sabedin Vishi:** Nëse iu referohem të dhënave dhe statistikave nga viti 2016, ulje me të madhe ka në vitin 2022. Nga viti 2019 ka ndryshuar pushteti, jeni thirrur shumë në shtimin e numrit të inspektorëve, kjo për mua është e mirëseardhur me u shtuar numri dhe me u mbikëqyrë puna e secilit mësimdhënës, mirëpo kjo ka mbetur vetëm në letër, sepse nga viti 2019 ka ra niveli i arsimit, ku është shkaktari është mirë me gjetur secili nga ne. Nuk është e vërtetë se nuk ka pasur rregull dhe rend në SHMP, se unë kam punuar aty dhe mundem me mbajte ligjëratë për këtë shkollë.

**z. Betim Shala:** E përshëndes vendimin e organeve komunale për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit të nxënësve të SHMP, por mendoj se kjo nuk është mënyrë për me ngritur nivelin në atë shkollë. Me ngritur nivelin në atë shkollë, duhet ndryshohen drejtimet teknike, jo me pasur çdo vit makineri, elektroteknikë, se pjesë e teknikës është edhe ndërtimtaria, gjeodezia, arkitektura. Unë besoj në rast hynë drejtime të cilat joshin dritë me shumë, e krijojmë njëfarë konkurrence dhe konkurrenca e ngrit nivelin në shkolla. Nëse për çdo vit janë të njëjtat drejtime, si instalues i nxehtësie, elektroteknikë dhe drejtime tjera që janë aty, nuk kanë edhe treg pune nëse dalin shumë nxënës që kryejnë këto drejtime, kështu që duhet hapen drejtime të reja teknike në SHMP.

**z. Naim Beça:** Për mua pika e parë, me brengosë fakti i orëve të humbura në shkolla të arsimtarëve. Në SHM "Skënderbeu" janë 707 orë të humbura e që në përpjesëtim për 25 nxënës në klasë fjala vjen, janë diku 17675 orë, kurse të SHMP janë 732 mungesa të orëve të humbura të arsimtarëve. Kjo i bie që për çdo ditë ka munguar nga 1 arsimtar, e që diku totali i vjen afër 36.000 orë të humbura. A është marrë ndonjë masë kundër këtyre arsimtarëve, se numri i orëve të humbura për 1 vit shkollor kujtoj se është shumë i madh. Orët e humbura, a janë të grevës, apo çka janë këto mungesa

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Pajohem me mendimin e Adnanit se nuk është stimulim një pagesë udhëtimit nxënësve që shkolla të nxjerrë profesionist. Ne nuk e dimë sesa zbatohet ana praktike e secilit nga drejtimet që janë në atë shkollë. Me tepër është dashur kjo shkollë t'i përkushtohet anës praktike të nxënësve, sesa stimulimi me bursa e që është bërë ndarje mes shkollave.

**z. Sabedin Vishi:** Nëse me keni dëgjuar më vëmendje, unë e potencova një statistikë të nxënësve të vitit 2021 të nxënësve të dalë nga kjo shkollë që janë punësuar, 51 nxënës. Nëse nuk i besoni të dhënave që i theksova unë, mund t'i merrni të dhënat të qendra e karrierës dhe SHMP. Sa i përket praktikave, në drejtimin instalues elektrik, mbahet praktika dhe dalin kuadro shumë të përgatitur. Gjithashtu edhe të ndërtimi i nxehtësie, ujësjellës dhe kanalizim mbahet praktika profesionale, të drejtimi automatik gjithashtu. Ngecje kemi të drejtimi juridik dhe drejtimi ekonomik. Jemi munduar për praktikë nëpër klasë, gjë që nuk është praktikë e mirë kjo. Para 5-6 viteve nxënësit kanë kryer praktika në banka, mirëpo tani nuk po i pranojnë. Të juridiku dhe ekonomiku kanë mbajte praktikë edhe në komunë, kemi marrëveshje edhe me

ETC për mbajtje të praktikave, por nuk është se u realizuar ende sa duhet. Të drejtimet tjera që i potencova, i kanë kabinetet, i kanë të gjithë mekanizmat nga A-ZH, nëse doni shkojmë e i vizitojmë kabinetet në SHMP se si funksionojnë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës u

#### NJOFTUA

**Me Informatën për përfundimin e Vitit shkollor 2021/2022 / Lënda: 01Nr. 60/01-27776/22.**

7. Propozim Vendimi për realizimin e një vizite studimore e Kuvendit të Komunës Kaçanik në Republikën e Shqipërisë;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, pasi jam me kompetent në këtë çështje, në zbatim të planit të punës së KK, kemi bërë përpjekje për realizimin e disa vizitave në Republikën e Shqipërisë në disa komuna. Vizita do të realizohen diku nga data 24-26 nëntor, në prag të festave të nëntorit në Bashkinë e Durrësit dhe atë të Tiranës dhe në autoritetin e portit të Durrësit. Në kuadër të kësaj vizite, do të vizitohen edhe ndonjë bashki tjetër, si Berati etj. E hapi diskutimin:

**z. Adnan Reka:** Ne, nuk do të ishim kundër ndonjë delegacioni të asamblesë komunale nga përfaqësuesit e subjekteve politike për ndonjë vizitë zyrtare me karakter pune në ndonjë vend tjetër. Por, jemi plotësisht kundër vizitave turistike nga buxheti komunal i taksapagueseve nga më të varfrit në vend. Dorën e 'zemër, nga vizitat "studimore" të deritanishme goxha përvoja t' 'mira na keni sjellë, si p.sh. çfarë drekë ju kanë dhënë kolegët e Beratit, si ishin ato dhomat e hotelit me 4 yje, si keni kaluar në 'autobus, e kështu me radhë, dhe prapë përvoja të tilla presim nga kjo vizitë; kush mbajti fjalim në Vlorë, kush çka hëngri, dhe kush vallëzoi më mirë nga asamblistët tanë. Por, është e padrejtë në këtë kohë krize ta shpërdoroni buxhetin komunal në Shqipëri, me vizita të kota të asamblistëve bashkë me ekzekutivin komunal. Festat e nëntorit mund t'i festoni edhe këtu, me shumë më pak shpenzime, sepse, është e turpshme që paratë e taksapagueseve nga më të varfrit në vend t'i shpenzoni në këtë mënyrë, e në anën tjetër të vazhdoni për dekada me radhë t'i mbani mbledhjet e kuvendit në 'tavan! e t' 'mos kemi një sallë kuvendi të dinjitetshme, ku mund t'ia hapim derën mysafirëve apo vizitorëve në shtëpinë tonë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Po të drejtohem personalisht Adnan. Ky nuk është vendim i imi, është propozim vendim dhe të njëjtin e miraton KK. Për vizitat e kaluara, ju nuk keni qenë dhe nuk e dini si janë zhvilluar, ndërkaq ka anëtarë të KK që kanë qenë në ato vizita. Për mua kjo është një obligim shtesë, sepse asgjë nuk është në dorën time, unë i përcjelli rregullat qysh i përcakton ligji, procedurat shkojnë me tenderim. Anëtarët e KK kanë nevojë që të dalin dhe të shohin bashkitë e ndryshme të Shqipërisë, e ju nuk i keni pa. Ata që kanë qenë munden me u deklaruar, unë nuk po deklaroj. Ka pasur organizata dhe mekanizma politik dhe jopolitik të cilët në mënyra të organizuara vizitojnë vende historike në bashki të ndryshme të Shqipërisë, si Berat e Gjirokastrë të cilat janë në mbrojtje të UNESCO dhe kushdo që mendon se mund përfitojmë nga vizitat, mund të përfitoj. Ka pasur diskutime në bashkinë e Beratit bashkë me kryetarin e këshillit të bashkisë, me drejtorët e këshillit bashkiak, nënkryetarin e këshillit bashkiak. Pritja që na është bërë, ka qenë fenomenale që nuk besoj se një delegacion shtetëror pritet ashtu, mund të flasin edhe tjerët jo vetëm unë. Janë shkëmbyer përvoja në fusha të ndryshme. Ky propozim vendim ka ardhur në bazë të kërkesave të anëtarëve të KK, në respektim të planit të punës së KK. Sa kanë me qenë vizitat e frytshme, nuk varen vetëm nga unë, varën nga angazhimi i juaj, se po shihet që ka anëtarë që janë kundër kësaj vizite.

**znj. Ardita Rrahmani:** Unë kam një pyetje shitesë për këtë çështje, adresuar kryetarit dhe kryesuesit. A bëni kryetar vizita të këtilla jashtë shtetit, sepse në vizita studimore janë për shkëmbime të përvojave nga teoria dhe praktika. Me vizita jashtë shtetit mund të thithim edhe investime? E tha edhe drejtori me herët kur u ndërlidh me këtë temë se nuk njihemi shumë si komunës për vizita jashtë shtetit. Qysh mundeni me thithur investime pa bërë vizita jashtë shtetit, përndryshe ata që shkojnë, lë të shkëmbejnë përvoja.

**Kryetari i Komunës-Besim Ilazi:** Unë aty ku e kam pa të arsyeshme, kam shkuar. Për shkak të obligimeve tjera që kam, ka pasur raste kur nuk kam shkuar në ndonjë vizitë e që ka qenë mirë me shkuar. E pranoj një dobësi të tillë, përndryshe çdo vizitë është e mirë, se njihesh me kulturën dhe historinë e atij vendi, por bashkëpunon edhe me zyrtarët e atij vendi dhe këmbëjmë përvoja të ndryshme. Shuma 500 € të cilat u përmenden, janë për një vizitë që e kam pasur në Stamboll, që ka organizuar GIZ, ku ka qenë edhe drejtori i DSHPE, dhe një zyrtari i bujqësisë që ka qenë në Greqi.

**z. Naim Beça:** A ka ndonjë plan sesa persona shkojnë në këtë vizitë studimore dhe kush shkon ? A ka ndonjë mysafirë special që vjen me neve, kush ka të drejtë me ftuar atë mysafir, me na dhënë sqarime me shumë, se vetëm me votuar pa i ditur këto të dhëna, po me duket e palogjikshme ?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Me një nen e kam cekur që, agjenda caktohet nga përfaqësuesit e subjekteve politike në bashkëpunim me kryesuesin. Tani pas mbledhjes e caktojmë se bashku me juve dhe e nënshkruaj, në mënyrë që të zhvillohen procedurat e prokurimit. Kontaktet e mia janë me bashkinë e Durrësit dhe Tiranës dhe portin administrativ të Durrësit. Në Vlorë do të vizitohet shtëpia e Pavarësisë 28 Nëntori, gjatë kthimit do t'ia bëjmë një vizitë Beratit. Numri që do të bëjë vizita është 30, nëse mungon ndonjë anëtar i KK, plotësohet nga ekzekutivi se është e nevojshme se ne nuk po jemi sa duhet të pajisur me informata, se ndryshe është me u përgjigjur një drejtor i fushës sesa ne. Ne do të përqendrohemi në mënyrën e qeverisjes lokale që na takon si KK. Jam duke bërë përpjekje që në kuadër të kësaj vizite të mbajmë një punëtori njëditore të përbashkët në një bashki, ku do të shkëmbehen përvoja të mira me ligjërues profesionist 1 nga Shqipëria e 1 nga Kosova, nga një asociacion që ka bashkëpunim me komunat e Shqipërisë dhe Kosovës, kjo do të jetë në tender dhe kompania është e obliguar t'i siguroj ekspertët.

**z. Naim Beça:** A keni bërë ftesa me ardhur edhe ata të Shqipërisë me vizituar komunën tonë, sepse vizita të tilla ndikojnë në ekonominë e vendit tonë, e jo vetëm ne me shpenzuar mjete atje ?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ideja e njërit që kam bashkëpunuar me të ka qenë që me i marrë nga 10 zyrtarë të komunës tonë atje dhe nga 10 me i sjellë këtu. P.sh. një zyrtar i gjendjes civile ka mundësi në të ardhmen me shkua me punua ne Berat apo Vlorë, dhe një zyrtar i tyre me ardhur me punuar këtu të ne.

**z. Adnan Reka:** Pajtohem plotësisht për shkëmbimin e përvojave mes zyrtarëve, ajo që me pyete me herët lidhur me përvojat që i keni ftuar, janë ato të cilat ju na i keni interpretuar, si drekat në Berat, akomodimi në hotele. Të shumta 560 € që i potencova, pse nuk janë regjistruar të zyra e kryetarit, por janë shpërndarë në 4 shërbime ? A iu ka dërguar GIZ apo keni shkuar me mjetet e juaja ?

**Kryetari i Komunës:** Ato mjete janë për mëditje, nuk thash se janë shpenzime të akomodimit e as të ushqimit. Mjetet janë të buxhetit dhe neve na monitoron dikush Adnan. Unë tregova se 3 zyrtar kanë shkuar në: Mal të Zi, Greqi dhe Stamboll, janë shpenzime të udhëtimit.

**z. Bahri Selimi:** E keni vërejtur sa shpenzojnë deputetet, anëtarët e komunave tjera për udhëtime jashtë vendit, çdo ditë i keni në lajme sesa shpenzojnë. Mundeni me i shpalosur raportet e me i pa. Ne jemi si komunë që shpenzojmë me së paku për udhëtime jashtë vendit, për 1 vit mund të arrijmë shumën diku 2,000€. Kemi me ua ofruar shënimet, janë paguar nga DBF 194€, 92€ nga DSHPE, nga DBPZHR 282€. Ku mundësi kur nuk ka mjete të zyra e kryetarit, i marrim mjetet nga ndonjë program tjetër buxhetor.

**z. Rrustem Zenuni:** Në emër të GP të PDK e përkrahim vizitën studimore si në propozim vendim, ndërkaq kërkoj nga grupet tjera parlamentare të përkrahin këtë vizitë e mos të ndahen se nuk është mirë me u ndarë. Ne po shkojmë për një arsye të mirë e të shëndoshë, besoj se kemi me kaluar mirë.

**z. Ekrem Livoreka:** Kërkoj një informacion shtesë: A kanë të drejtë me aplikuar kompanitë nga komunat tjera në tender për këtë vizitë zyrtare, apo vetëm kompanitë e komunës tonë ?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nuk është as iniciativë as nismë, vizita është e paraparë me planin e punës së KK. Procedura e tenderimit është e hapur për të gjithë pa përjashtim. Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 18 votë Për (12 LDK, 2 AAK, 4 LDK), Kundër ishin 5 anëtarë nga LVV, Abstenuan 2 anëtarë nga LVV, Raif kasa dhe Naim Beça. Pjesëmarrës në votim ishin 25. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### **VENDIM**

**Për realizimin e një vizite studimore e Kuvendit të Komunës Kaçanik në Republikën e Shqipërisë / Lënda: 01Nr. 60/01-27947/22.**

**8. Propozim Vendimi për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2022;**

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**z. Adnan Reka:** Transferet e mjeteve buxhetore dhe ndërrimi i destinimit të tokave janë vendimet më shpeshta dhe të pa drejta që ky kuvend ka marrë në vazhdimësi. A nuk transferuat në vazhdimësi para nga një kategori ekonomike në kategorinë tjetër, nga një program buxhetor në një program tjetër, madje në muajin prill të këtij viti transferuat edhe 270.000 euro nga rezerva komunale, dhe nuk po ju mjaftojnë assesit, çfarë ju duhet planifikimi buxhetor, kur ju planet i ndryshoni për çdo muaj.

**z. Bahri Selimi:** Këto propozim vendime që i sjellin në KK, janë me të vetmin qëllim që komuna me shpenzuar buxhetin në përqindje sa me të lartë. Mjetet të cilat i shohim se nuk po realizohen, si çështja kur ka ngecje ndonjë projekt, se jemi ballafaquar me pandemi, inflacion, rritje të vazhdueshme të çmimeve, vështirësitë që po i kanë operatorët ekonomik. Mjetet janë GQ dhe po i transferojmë aty ku ka mundësi me i shpenzuar e mos me i kthyer në suficit buxhetor. Me kërkesën e DSHPE të pika 2, transferet e mjeteve nga kategoria e IK, po i marrim mjetet nga vendosja e post kabinave gjatë rrugëve lokale shuma 1023€, në bashkëpunim me menaxherin e projektit është vërejtur se edhe shuma 1773€ mundet me mbetur mos me u shpenzuar dhe kjo shumë me u ndryshuar 2,796,82€ nëse ka mundësi se e kemi bërë me vonesë këtë ndryshim. Sa me shumë të shpenzojmë mjete nga kodi buxhetor 10 nga GQ. Të pika 1 është ndërtuar salla e edukatës fizike në shkollën e Begracës, për shkak të çmimit më të ulët të nënshkrimit të kontratës, mbesin mjete 19,035.23€. Këto mjete jemi duke i transferuar të kategoria e mallrave dhe shërbimeve të drejtorisë e Arsimit, për shkak se peleti është kontraktuar me lirë, ndërkaq tani është ngritur çmimi i peletit. Shuma 14,035,23€ transferohen në arsimin fillor dhe shuma 5,000€ të administrata e arsimit.

**z. Adnan Reka:** Faleminderit drejtor për përgjigjet. Ne jemi bukur të qartë të pika 1, mjetet po kalojnë nga arsimi në arsim, të e dyta po kalojnë në rrugë lokale, kështu edhe të e treta. Është dashur planifikimin të bëni më herët, se çfarë kuptimi ka atëherë planifikimi buxhetor, ku çdo muaj bëhet transfer i mjeteve. Afër 270,000€ që u morën nga rezervat, a nuk iu mjaftuan ato për peletë, dru, a çka do të blini, por nën stop bëhen transfere nëpër rrugë etj. Është e drejtë e juaja si i menaxhoni të hyrat, ne nuk pajtohemi me u bërë këto transfere.

**Kryetari i Komunës:** Edhe ne kemi gabime dhe mund të gabojmë se njerëz jemi, nuk janë krejt gabimet e tona, por janë pengesa e procedurave për shkak të kushteve dhe rrethanat që krijohen. E kemi obligim me bërë rishqyrtimin e buxhetit, gjë që nuk po na lejohet. Inflacioni, ligjërisht qeveria është dashur me na lejuar kompanive që kanë hyrë me çmim 50 cent, e tani janë bërë kontratat 1 euro e 30 cent. OShP duhet me na kthyer përgjigje brenda 30 ditëve, ndërkajq ne nuk po marrim përgjigje as pas 3 muajve. Janë këto pengesa që po na detyrojnë me bërë transfer të mjeteve, përkundër të metave tona. Duke i marrë parasysh këto situata, po na detyrojnë me gjetur formën me shpenzuar GQ që mos të shkoj në suficit buxhetor. Vitin e kaluar peleti ka qenë 210€ tani është 570€, kontrata është e nënshkruar, këto janë problemet që po na detyrojnë me i bërë këto transfere.

**z. Adnan Reka:** Faleminderit për sqarimin kryetar, rishikimi i buxhetit është hequr me ligj, ndërkajq qeveria e ka miratuar transferin, por transferi nuk nënkupton çdo muaj me pasur transfer dhe si referencë tërë kohën po e përmendni peletin.

**Kryetari i Komunës:** Qeveria e ka bërë rishikimin e buxhetit, në rregull, nuk jemi kundër asaj, Unë po pres që 8 javë, pasi e ka dhënë përgjigjen eksperti në favor që është zgjedhur kompania me çmim me të ulët për rrugën: Teneq-Stagovë, pres përgjigje nga OShP se ata po thirren në atë se janë shumë të ngarkuar, afati është 30 ditë. Unë jam detyruar me i marrë disa mjete me i dërguar diku tjetër. Rastin të Çarshia e qytetit, ku është nënshkruar kontrata vitin e kaluar me çmimin e tregut në atë kohë, kompania thotë se nuk kam mundësi me punuar më çmimin që ka nënshkruar kontratën. Ne kemi kërkuar përgjigje prej qeverisë nga muaji qershor, në korrik kemi qenë të zëvendësministri i infrastrukturës me drejtorin Ramadush Osmani, presim reflektim të qeverisë për me mundur me i stimuluar këto dhe kjo nuk është bërë deri me tani. Pikërisht këtu jemi duke marrë mjetet dhe jemi duke i transferuar aty ku kemi nevojë.

**z. Adnan Reka:** Qeveria e ka potencuar se i ka ndaluar disa mjete për shkak të rritjes së çmimeve, por kjo nuk me arsyeton faktin që çdo muaj me bërë transfer.

**z. Bahri Selimi:** Unë mendoj që ligjin nuk bënë me shkel, a me shfrytëzuar ligjin është mirë. Mundet me ndodhë që edhe në mbledhjen vijuese ka mundësi me sjellë ndonjë transfer. Çështja e peletit nuk mundemi me i zhvilluar procedurat në pranverë, kjo lidhet me sezonin. Për çështjen e peletit, ky propozim është aktual se ne jemi duke blerë peletin me hyrë në dimër, procedurat janë udhëhequr dhe janë arritur, por kur të vjen puna e furnizimit, ne nuk i kemi mjetet se janë ngritur çmimet dhe ngritje të tilla kanë atakuar kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Me ndryshimin që e potencoj drejtori i DBF, Bahri Selimi, Propozim vendimin e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 14 votë Për (PDK, AAK) Kundër 10 (6 LVV, 4 LDK), Abstenoj 1 nga LVV- Raif Kasa. Pjesëmarrës në votim 25. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2022/ Lënda: 01Nr. 400/03-28129/22.**

## 9. Propozim Vendimi për transferin dhe rialokimin e mjeteve buxhetore;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Para se me hapur diskutimin, fjalë e ka drejtori i DBF Bahri Selimi.

**z. Bahri Selimi:** Për me dalë sa me mirë me shpenzim të buxhetit, pasi e kemi dërguar vendimin paraprak, ka lindur nevoja edhe një propozim tjetër pak me vonesë. I falënderoj anëtarët e KPF për mirëkuptimin, se ka lindur nevoja e transferit dhe rialokimit të mjeteve. Të shpronësimet i kemi pasur mjetet diku 30,000 €, ligji nuk me lejon me i tërhequr krejt këto mjete, dhe kam shkuar 19,350 € të nën programit buxhetor. Këto mjete i dërgojmë me një kod për shpenzim në rrugë lokale, sepse kontratë ka, por nuk ka mjete. Të projekti që u përmend Çarshia e Qytetit, për shkak të mos ndryshimeve të çmimeve, me u mbuluar humbjet nga inflacioni, në seancën e kaluar i kemi hequr 25.000€, tani hiqen edhe 45,000€, se kontrata është lidhur në vitin e kaluar. Jemi duke i tërhequr mjetet brenda kontratës pa e rrezikuar kontratën. Operatori ekonomik nëse donë me punuar prapë mundet, nuk rrezikohet asgjë, mjetet me kontratë janë, por ne jemi duke folur për shumën mbi kontratën, se ne zakonisht planifikojmë dhe nuk kemi të drejtë më dhënë kontratën një operatori ekonomik nëse oferta e kalon buxhetin, por nëse oferta është nën planifikim buxhetor. Mjetet shkojnë nga investimet kapitale në investime kapitale, kjo është me e mirë se nuk po i transferojmë mjetet në pozicionin e mallrave dhe shërbimeve dhe po e rrisim shkallën e shpenzimeve të IK.

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**z. Adnan Reka:** Si duket nga një transfer i mjeteve brenda muajit, por nga dy transfere brenda muajit. Për mua kjo është e papranueshme.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 14 votë Për (LDK, AAK), Kundër ishin 9 (5 nga LVV dhe 4 LDK), Abstenoj Raif Kasa nga LVV. Pjesëmarrës në votim, 24 anëtarë, për shkak se anëtarja Kadrije Lika Troni kur u shtrua në votim kjo pikë nuk ishte në sallë. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

### VENDIM

**Për transferin dhe rialokimin e mjeteve buxhetore ?Lënda: 01Nr. 104/02-28334/22.**

Mbledhja i përfundoi punimet në ora 13:15. Deri në fund të mbledhjes qëndruan anëtarët 25 anëtarë, ndërkaq me arsye Agim Çaka doli nga mbledhja gjatë shqyrtimit të pikës 2.

Pas mbledhjes Kryesuesi i Kuvendit dhe anëtarët e KK (femrat) u ndalën për me formuar Grupin Joformal të Grave Asambleiste.

Procesmbajtëse  
Makfire Malsiu

*Makfire Malsiu*



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Murseli

*Kemal Murseli*

**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS**  
**(të zgjedhur në votimet e datës 17 Tetorit 2021);**

**Nga Mbledhja e X (dhjetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2022, mbajtur me 26.10.2022:**

1. Kemal Murseli .....,
2. Brahim Imishti.....,
3. Hamide Luma .....,
4. Kadri Krivenjeva .....,
5. Fitore Vishi,.....,
6. Rrustem Zenuni,.....,
7. Edon Baftiu .....,
8. Selajdin Troni .....,
9. Fatmir Bunjaku .....,
10. Bashkim Krasniqi .....,
11. Florina Lika-Vishi .....,
12. Lejla Muhaxheri-Çaka.....,
13. Agim Mani .....,
14. Kadrije Lika-Troni .....,
15. Adnan Reka .....,
16. Naim Beça .....,
17. Raif Kasa .....,
18. Ernesta Krasniqi,.....,
19. Bashkim Luma .....,
20. Arta Avdiu .....,
21. Ardita Rrahmani .....,
22. Besnik Salihu .....,
23. Betim Shala,.....,
24. Arlinda Rakoci-Raka.....,
25. Rabije Sallahi.....,
26. Ekrem Livoreka.....,
27. Agim Çaka......